

Mirë se vini në shkollën fillore

Botimi 2024 Versioni shqip

Fëmija juaj hyn në shkollën publike të Gjenevës. Kjo broshurë shpjegon se si funksionon dhe ju jep informacione praktike.

Shkolla fillore është hapi i parë në formimin e qytetarëve të së nesërme. Nxënësit zhvillojnë njohuri dhe aftësi të përshtatshme për moshën e tyre, në një mjedis mikpritës dhe stimulues.

Faqet e fundit të kësaj broshure, të lidhura me një video, i kushtohen posaçërisht klasës 1 fillore (1P).

Ju do të gjeni informacione shtesë duke klikuar linkun :

edu.ge.ch/qr/bienvenue



Shkolla e detyrueshme e Gjenevës

Shkolla fillore e Gjenevës mirëpret fëmijët tuaj që jetojnë në kanton të cilët kanë mbushur moshën 4 vjeç më 31 korrik para fillimit të vitit shkollor.¹

Kjo përfshin dy cikle katërvjeçarë :

- cikli fillor (nga 1P në 4P) për nxënësit nga 4 në 8 vjeç.
- cikli i mesëm (nga 5P në 8P) për nxënësit nga 8 në 12 vjeç.

Sipas ligjit të Gjenevës, shkollimi është i detyrueshëm deri në moshën 18 vjeç. Në përfundim të ciklit orientues (cycle d'orientation), ai vazhdon në arsimin e mesëm II.

Jeta shkollore

Orari

Që nga 1P deri në 4P, nxënësit shkojnë në shkollë katër ditë në javë (të hënën, të martën, të enjten dhe të premten), nga ora 8 :00 deri në orën 11 :30 dhe nga ora 13 :30 deri në orën 16 :00². Në 1P dhe 2P, nxënësit mund të vijnë në klasë deri në orën 8 :45 në mëngjes dhe në orën 14 :00 në drekë. Kohët e pushimit janë parashikuar në mëngjes dhe në drekë. **Nisur nga 5P**, shkolla zhvillohet edhe të mërkurën paradite.

Gjatë orëve të mësim, nxënësit janë nën përgjegjësinë e ekipit mësimor. Jashtë këtij orari, fëmijët mbeten nën përgjegjësinë e prindërve të tyre.

Frekuentimi i shkollës është i detyrueshëm (duke përfshirë daljet dhe aktivitetet e organizuara gjatë orarit të shkollës). Në rast të mungesës të paparashikuar, ju lutemi kontaktoni shkollën sa më shpejt të jetë e mundur. Për çdo situatë tjetër, mund t'i referoheni termave dhe kushteve të përshkruar në faqen e internetit të shkollës së fëmijës suaj.

Aksesi në faqen e internetit të shkollës së fëmijës suaj : edu.ge.ch/primaire (Démarches parents – rubrika Absence)

Pritja pas shkollës

Përveç orarit shkollor, për fëmijën tuaj mund të kujdeset një ekip profesional argëtimi pas shkollës :

- ndërmjet orës 11 :30 dhe 13 :30, për të ngrënë një vakt dhe për të kryer aktivitete deri në kthimin në klasë,
- ndërmjet orës 16 :00 dhe 18 :00, për të ngrënë një vakt të lehtë dhe për të bërë aktivitete.

Kujdesi jashtëshkollor organizohet nga GIAP (Grupi Ndër komunal për Aktivitetet Jashtëshkollore) dhe bashkitë. Aktivitetet jashtëshkollore janë me pagesë.

Si duket një ditë e zakonshme pas shkollës? giap.ch/parascolaire

Regjistrimet kryhen në platformën my.giap.ch (periudha zyrtare e regjistrimit dhe informacione të tjera mund t'i gjeni në giap.ch ose me anë të telefonit në numrin 022 304 57 70).

Pushimet

Viti shkollor fillon më 19 gusht 2024 dhe mbaron më 27 qershor 2025. Nxënësit nuk shkojnë në shkollë gjatë pushimeve zyrtare dhe pushimeve shkollore. Kalendarin shkollor e gjeni në ge.ch/vacances-scolaires-jours-feries

Pushimet shkollore

Jeûne genevois e enjte 5 shtator 2024	Pushimet e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri nga e hëna e 23 dhjetorit 2024 deri të premten e 3 janarit 2025	Pushimet e Pashkëve nga e premtdja 18 prill deri të premten e 2 majit 2025	Pentecôte e hëna 9 qershor 2025
Pushimet e vjeshtës nga e hëna 21 tetorit deri të premten e 25 tetorit 2024	Pushimet e shkurtit Nga e hëna 24 shkurtit deri të premten e 28 shkurtit 2025	Pont de l'Ascension e enjte 29 maj dhe të premten 30 maj 2025	Pushimet verore që nga e hëna 30 qershor 2025

¹ Në nënkuptojmë vendin ku jeton fëmija dhe të paktën njëri nga prindërit e tij. Personat që kanë autoritetin prindëror konsiderohen prindër, në të kundërtën përfaqësuesi ligjor (LIP, neni.3).

² Në 1P, nxënësit mund të ndjekin shkollën me kohë të pjesshme, në mëngjes (LIP, neni.55). Kjo zgjedhje duhet të komunikohet nga prindërit gjatë regjistrimit.

Materialet

Mësimi është falas. Fëmija juaj merr materialet e nevojshme : tekste shkollore, lapsa, goma, lidhëse, fletore, etj. Këto pajisje duhet të respektohen dhe mirëmbahen me kujdes. Prindërit ofrojnë vetëm sendet personale (pantofla, përparëse për pikturë, veshje sportive, etj.). Mësuesja ose mësuesi i fëmijës suaj do t'ju japë informacion të detajuar.

E drejta e imazhit

Mbrojtja e të drejtave të imazhit të nxënësve është e garantuar (do t'ju jepet një formular).

Organizimi i shkollës

Ekipe profesionale në shërbim të nxënësve

Një ekip profesional punon në zinxhir për të mbështetur të gjithë nxënësit në aspekte të ndryshme të jetës shkollore.

Klasa është nën përgjegjësinë e një mësuese ose mësuesi të cilin mund ta kontaktoni për çdo pyetje ose kërkesë në lidhje me arsimimin e fëmijës suaj.

Për artin, sportin dhe mbështetjen arsimore, me nxënësit punojnë edhe mësuese ose mësues të tjerë.³

Përveç kësaj, një ekip multidisiplinar (infermiere ose infermier, mësuese ose mësues të specializuar dhe edukatore ose edukator, etj.) mbështet nxënësit dhe ekipin mësimdhënës.

Shkolla drejtohet nga një drejtoreshë ose drejtor, i mbështetur nga një ekip drejtues i përbërë nga mësuese dhe ndihmës mësues, si dhe një koordinatore ose koordinator arsimor dhe nga sekretaria.

Përveç kësaj, personeli shëndetësor ndërhyr herë pas here në shkollë si pjesë e promovimit dhe parandalimit të shëndetit (ekzaminimi i syve dhe dëgjimit, kontrolli për gjendjet orale dhe dentare, edukimi shëndetësor).

Mësimdhënia

Aktivitetet e kryera në shkollë janë pjesë e një projekti të përgjithshëm trajnimit të përcaktuar nga Plani i Studimit Romand (Plan d'étude Romand PER). Për të mësuar dhe nxënë, burimet e mësimdhënies romande (MER) janë të disponueshme në të gjitha klasat. Ato plotësohen nga burime të tjera të ofruara nga mësueset ose mësuesit.

Aktivitetet jashtëshkollore (vizitat nëpër muze, kurset shkollore, kampet, etj.) kontribuojnë gjithashtu në formimin e nxënësve.

Faqja e PER dhe e MER :

per-mer.ch

Dokumente informuese rreth PER : edu.ge.ch/qr/per-parents

Faqja pedagogjike e mësimdhënies fillore : edu.ge.ch/enseignement/ep

Vlerësimi për të nxënë

Mësimi akademik vlerësohet gjatë gjithë vitit. Kështu, vlerësimi jep informacion mbi situatën akademike të fëmijës suaj.

Metodat e vlerësimit zhvillohen gjatë shkollimit. Në ciklin fillor (1P-4P) ecuria e nxënësit vlerësohet me vlerësime. Nga cikli i mesëm (5P-8P), lëndët i nënshtrohen vlerësimit në formën e një vlerësimi ose një note (në një shkallë nga 1 në 6).

Buletini i shkollës (bulletin scolaire) është dokumenti zyrtar që synon t'ju ofrojë rezultatet e vlerësimit të fëmijës suaj. Ai ju jepet në fund të çdo semestri. Përsa i përket **librezës së arsimit të detyrueshëm** (livret de scolarité obligatoire - LSO), ajo është dokumenti zyrtar referues për përparimin e fëmijës suaj në shkollat e Gjenevës.

³ Mësues të disiplinave artistike dhe sportive (MDAS), mësues përgjegjës për mbështetjen arsimore (ECSP). Në ciklin e mesëm, disiplina të tjera u besohen mësuesve shtesë.

Një shkollë që kujdeset për të gjithë nxënësit

Shkolla ka disa metoda të mbështetjes së nxënësve për të kontribuar në suksesin e tyre akademik sipas nevojave dhe aftësive të tyre : mbështetje arsimore, detyra shtëpie të mbikëqyrura, klasa për nxënësit që nuk flasin frëngjisht (classe d'accueil), masa mbështetëse dhe përshtatje akademike, përshtatje shkollore, mësimdhënie e specializuar, sistem i studimeve sport-art-mësim, përfshirje në kriterit të moshës.

Mund të gjeni më shumë informacion në faqen e internetit të shkollës së fëmijës suaj : edu.ge.ch/primaire (Enseignement – rubrika Corps enseignant dhe rubrika Soutiens et aménagements scolaires) dhe në broshurën *Comment l'école soutient votre enfant ?* [ge.ch/document/ comment-ecole-soutient-votre-enfant](http://ge.ch/document/comment-ecole-soutient-votre-enfant)

Bashkëpunimi midis shkollës dhe prindërve

Misioni i shkollës është të plotësojë veprimin edukativ të familjes. Së bashku, ne mund të mbështesim zhvillimin dhe ekuilibrin e fëmijës suaj dhe të ndikojmë pozitivisht në shkollimin e tyre.

Mësuesja ose mësuesi i klasës është personi juaj i preferuar i kontaktit, i cili ju informon rregullisht për situatën akademike të fëmijës suaj dhe me të cilin mund të diskutoni shumë aspekte të shkollimit të tij.⁴

Të paktën tre takime janë planifikuar gjatë vitit shkollor :

- një takim kolektiv i prindërve përpara fundit të shtatorit,
- një takim individual nga fundi i tetorit deri në fillim të dhjetorit,
- një takim gjatë semestrit të dytë, mënyrat e të cilit mund të ndryshojnë në varësi të shkollës.

Ju mund të kërkonte një takim në çdo kohë nëse është e nevojshme, sipas mundësisë së mësueses apo mësuesit, për shembull nëpërmjet fletores të nxënësit që merr fëmija juaj në fillim të vitit shkollor. Shkolla mund të thërrasë përkthyes nëse është e nevojshme.

Fletorja e nxënësit si dhe, sipas mënyrave lokale, një fletore komunikimi sillet rregullisht në shtëpi për të mundësuar shkëmbimet mes familjes dhe shkollës.

Shoqatat e prindërve të nxënësve

Në shumë shkolla, ekziston një shoqatë e prindërve të nxënësve (APE) e cila ndihmon në promovimin e dialogut midis familjeve dhe shkollës. Ju mund të kontaktoni ose të bashkoheni me APE të shkollës së fëmijës suaj nëse dëshironi të takoni prindër të tjerë dhe të merrni informacion rreth aktiviteteve të organizuara.

Federata e Shoqatave të Prindërve të Arsimit të Detyrueshëm (FAPEO) : fapeo.ch

Organet pjesëmarrëse

Për të inkurajuar shkëmbimet ndërmjet shkollës dhe partnerëve të saj, çdo institucion ngre një organ pjesëmarrës. I kryesuar nga drejtorja e shkollës, ai mbledh së bashku përfaqësues të shoqatës lokale të prindërve (APE), komunës, Grupit Ndërkomunal për Aktivitete Jashtëshkollore (GIAP) dhe ekipit mësimor.

Takimet e organizuara gjatë vitit shkollor ofrojnë hapësirë për informacion, konsultim dhe propozime në lidhje me shkollën dhe mjedisin e saj.

Informacion në faqen e internetit të shkollës së fëmijës suaj : edu.ge.ch/primaire (Vie & Règles de l'école – rubrique Instances participatives)

Kurs i gjuhës dhe kultura e origjinës (LCO)

Disa konsullata dhe shoqata ofrojnë kurse të gjuhës dhe kulturës së origjinës (LCO) me regjistrime për të promovuar praktikën e gjuhës dhe kontaktin me kulturën e origjinës.

Lista e organizatave me të cilat DIP bashkëpunon është e disponueshme në faqen e internetit të *Enseignement* : edu.ge.ch/qr/lco

⁴ Përveç kësaj, prindërit konsultohen përpara çdo vendimi të rëndësishëm në karrierën shkollore të fëmijës së tyre.

Të zbuloni klasën e pare 1P

Këto faqe plotësojnë videon *Një ditë në një klasë të 1P*

edu.ge.ch/qr/bienvenue



Hyrja e fëmijës suaj në shkollën fillore është një hap i rëndësishëm që sjell ndryshime për të gjithë familjen. Së bashku, ne mund t'i bëjmë fëmijët tuaj të dëshirojnë të vijnë në klasë për të mësuar me kuriozitet.

Objektivi i dy viteve të para (1P dhe 2P) është të mirëpresin dhe mbështesin çdo nxënës, të zhvillojnë të folurin (të kuptuarit dhe të shprehurit) dhe të hyjnë gradualisht në mësim përmes lojës dhe zgjidhjes së problemeve të thjeshta ushtrimeve, memorizimit, etj.

Nuk ka parakushte përse i përket të mësuarit në shkollë dhe familjet nuk pritet që t'i trajnojnë fëmijët me aftësi përpara se të hyjnë në shkollë.

Me ndihmën e ekipit mësimdhënës dhe në bashkëpunim me shokët e klasës, fëmija juaj do :

- të zbuloj një mjedis të ri dhe të përshtatet me funksionimin e tij,
- të hapet me të tjerët dhe ndërveproj në klasën dhe shkollën e tij,
- të mësoj të ndajë vëmendjen e mësueses ose mësuesit me nxënësit e tjerë,
- të zhvilloj njohuri dhe aftësi të reja përmes aktiviteteve dhe përvojave të shumta.

Për ta bërë të mundur që ai të hyjë në shkollë me besim, mund ta inkurajoni fëmijën tuaj të bëhet gjithnjë e më i pavarur në aktivitetet e përditshme.

Gjatë gjithë shkollimit, fëmija juaj do të mbështetet nga mësueset ose mësuesit e tij me të cilët do të punoni ngushtë. Një ekip profesional do të jetë gjithashtu i disponueshëm nëse është e nevojshme (veçanërisht drejtoresha ose drejtori, mësueset ose mësuesit përgjegjës për mbështetjen arsimore, mësueset ose mësuesit e specializuar, edukatorja ose edukatori, infermierja ose infermieri).

Gjatë dy viteve të para, mësimi organizohet kryesisht rreth :

- **Socializimi për të mësuar në grup;** fëmija juaj do të mësojë të ndjekë rregullat e jetës në klasë dhe në shkollë (respektimin e kufijve të këndit të lojërave, të marrë parasysh të tjerët, të presë radhën, etj.).
- **Ndërtimi i njohurive për të kuptuar botën** përmes temave dhe aktiviteteve që mobilizojnë disa disiplina të Planit të Studimit Romand (PER).
- **Zbatimi i mjeteve mësimore** që hapin derën e njohurive, informacioneve dhe aftësive ndër personale (dëgjimi, bashkëpunimi, dhënia e mendimit të tij, përqendrimi, memorizimi, planifikimi, zgjedhja e strategjisë së duhur për të zgjidhur një problem, etj.).

Gjatë ditës ofrohen metoda të ndryshme mësimi, të tilla si :

- Koha e lojës i lejon të mësojnë, zhvillojnë kreativitetin, bashkëpunimin, komunikimin dhe përshtatin sjelljen në varësi të situatës.
- Momente shkëmbimi për të zhvilluar gjuhën, për të dhënë shpjegime, për të zgjidhur konfliktet, për të mësuar të dëgjojë të tjerët dhe të marrë parasysh mendimet e tyre.
- Veprimtaritë zbuluese për të ndërtuar njohuri të reja, në ndërveprim me mësuesen ose mësuesin dhe shokët e klasës.
- Aktivitete trajnuese për konsolidimin e të nxënës dhe zhvillimin e pavarësisë (duke ndjekur individualisht udhëzime të thjeshta, në grupe të vogla, etj.).

Dita zhvillohet në klasë dhe në vende të tjera në shkollë, apo edhe jashtë (ndër të tjera, sallë lojërash, palestër, pishinë, bibliotekë, kënd lojërash, teatër, muze, park).

Hapat e ardhshëm para fillimit të vitit shkollor :

- Regjistrimi për aktivitetet jashtëskollore të ofruara nga GIAP nëpërmjet platformës my.giap.ch (periudha e regjistrimit zyrtar dhe informacioneve të tjera mund t'i gjeni në giap.ch ose me anë të telefonit 022 304 57 70)
- Në disa komuna : mbështetje për fëmijët dhe prindërit (për shembull : *Së shpejti në shkollë !* Zyra e Integritimit dhe Shtetësisë : bientotalecole.ge.ch)
- Mbledhje informative, vizitë në klasë etj. (sipas kushteve të çdo shkolle)
- Gjatë muajit korrik : letër për fillimin e vitit shkollor (informacion praktik)

Nëse ndryshoni banimin përpara fillimit të vitit shkollor, duhet të informoni drejtorinë e shkollës në të cilën keni regjistruar fëmijën tuaj.